

Vizat aeroportuale, tip A

Përshkrimi

Pajisja me viza A, transit aeroportual, për shtetasit e huaj.

Dokumentacioni i nevojshëm

- Formulari i aplikimit;
- Fotografi e 6 muajve të fundit;
- Fotokopjen e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit, (i cili duhet të jetë me vlefshmëri së paku 3 muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar);
- Sigurimi shëndetësor (i cili mbulon kohëzgjatjen e vizës);
- Deklaratën ku shprehet pëlqimi i prindit ose i kujdestari ligjor për udhëtimin e fëmijës, ose personi që e ka në ngarkim;
- Ftesa e nënshkruar nga ftuesi, nëse ka të tillë;
- Fotokopja e vizës së vendit destinacion (nëse duhet vizë për atë vend);
- Kartelën e vaksinimit kur i huaji vjen nga vende të prekura nga epidemi ose sëmundje;

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale (të paktën kur kryen për herë të parë aplikimin);
- 2) Plotësimi i formularit të vizës;
- 3) Plotësimi i formularit të vizës për fëmijë bëhet nga njeri ose dy prindërit, ose kujdestari ligjor ose personi që e ka në ngarkim;
- 4) Paraqitja personale për marrjen e vizës

Tarifa e shërbimit dhe afati

- 1) Me reciprocitet, në bazë të VKM 513/13;
- 2) Pa pagesë:
 - Fëmijët deri 6 vjeç;
 - Mbatësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit;
 - Anëtarët e organizatave jofitimprurëse nën 25 vjeç;
 - Nxënësit e shkollave, studentët, studentët pasuniversitare për motive studimi ose trajnimi arsimor;
 - Studiues që kryejnë kërkime shkencore;
 - Raste humanitare;
- 3) Viza për fëmijë nga 6-12 vjeç sa gjysma e tarifës së vizave për të rritur;
- 4) Afati i vlerësimit të kërkesës zgjat deri në 15 ditë;

Zyra

Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Vlefshmëria e kësaj vize jepet në përputhje me kohën dhe rezervimet e biletave për udhëtimin në të cilin aplikuesi kërkon të udhëtojë në tranzit aeroportual .

[Formulari për aplikimin për vizë.](#)